



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA

AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

Nr. 1638 prot.

Tiranë, më 06-10-2022

URDHËR

NR. 82, DATË 06-10-2022

PËR

**METODOLOGJINË PËR HARTIMIN DHE ZBATIMIN E  
PLANEVE/PROGRAMEVE TË MONITORIM / KONTROLLIT**

Në zbatim të pikës 2, të kreut II, të germës a), të pikës 3 dhe të germës a), të pikës 4, të kreut III të vendimit nr.221, datë 26.04.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, me qëllim standardizimin e hartimit të programeve të monitorim/kontrollit në shërbim të zbatimit të detyrave funksionale të strukturave të monitorim/kontrollit të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Zyrave të Administrimit të Baseneve Ujore,

URDHËROJ:

- I. Miratimin e metodologjisë për hartimin dhe zbatimin e planeve/programeve të monitorim/kontrollit, si më poshtë:
  1. Kriteret teknike të hartimit të planit/programit të monitorim/kontrollit të ri (plani vjetor 2023 por edhe muajt e mbetur të 2022).
    - a) Duhet të mbajë në konsideratë (sipas kësaj radhe):
      - i. Monitorimin e të gjithë subjekteve të cilët rezultojnë të pajisur me leje/autorizim, të cilët nuk janë monitoruar asnjëherë nga strukturat e menaxhimit të burimeve ujore;
      - ii. Monitorimin e subjekteve të cilëve u përfundon leja dhe të cilët parashikohet të aplikojnë për rinovimin e lejes/autorizimit ekzistues. Kjo pasi të jetë kryer komunikimi i detyrueshëm sipas përcaktimeve të VKM nr.550, pika 21 e Kreut V. Gjithsesi, meqenëse mungesa e këtij komunikimi nuk parashikohet si kusht për heqjen e lejes, ZABU duhet të identifikojë në vazhdimësi subjektet në fjalë

dhe të parashikojë gjatë vitit (muajit) monitorimin e tyre me qëllim që të mos shkaktohen vonesa në procesin e trajtimit të aplikimit të subjektit për mungesë të këtij detyrimi që kanë AMBU&ZABU;

- iii. Monitorimin e subjekteve me leje/autorizim me frekuencë të paktën 1 herë në vit;
- iv. Monitorimin e zbatueshmërisë së programit të masave të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor, që janë përgjegjësi e ZABU-së për zbatim dhe që i përkasin fushës së monitorim/kontrollit të trupave ujqorë.

b) Njëkohësisht, duhet të mbajë në konsideratë:

- i. Monitorimin periodik të shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjve dhe rehabilitimin e tyre nga subjektet e pajisura me leje me një frekuencë të paktën një herë në muaj (në lidhje me shfrytëzimin racional të tyre sipas grafikëve të parashikuar dhe rehabilitimin e zonës së shfrytëzimit, përgjatë afatit të lejes dhe përfundimit të saj);
- ii. Kontrollin e vazhdueshëm të lumenjve dhe përrenjve për të identifikuar rastet e shfrytëzimit të materialeve inerte pa leje, me një frekuencë të paktën 2 herë në vit, të paktën për segmentet e lumenjve/përrenjve të cilët kanë potencial për shfrytëzim të paligjshëm të inerteve;
- iii. Të monitorojë ecurinë e ndërtimit të HEC-eve të pajisur me leje, të paktën në fazën fillestare të ndërtimit për të siguruar vendodhjen e saktë kundrejt përcaktimeve të lejes si edhe në fazat finale të ndërtimit për të siguruar ndërtimin e komponentëve të HEC-it sipas dokumenteve të lejes dhe miratimit;
- iv. Monitorim/kontrollin e subjekteve që përdorin burimet ujore pa leje sipas informacioneve që ZABU disponon ose mund të disponojë apo verifikimeve në terren.

c) Gjithashtu, duhet të mbajë në konsideratë:

- i. Parashikimin e monitorimeve në bashkëpunim me DRM-të në lidhje me identifikimin e ndotjes së mundshme të burimeve ujore të basenit me qëllim parandalimin dhe shmangien e ndotjes së burimeve ujore pritëse;
- ii. Në çdo rast të mundshëm të monitorim/kontrolleve, të përmendura në gërmat e mësipërme {a} dhe b)}, të përdoren pajisjet monitoruese për parametrat e cilësisë së ujërave;
- iii. Të rakordojë procesin e monitorim/kontrollit me procesin e faturimit të subjektit.

2. Kriteret operacionale të hartimit të planit të monitorim/kontrollit të ri (plani vjetor 2023 por edhe muajt e mbetur të 2022):
- a) Grupimi i destinacioneve për t'u monitoruar, sipas zonës/territorit ku ndodhet burimi/burimet, me qëllim optimizimin e përdorimit të automjeteve, kohën e udhëtimit dhe shmangies së dublimit të udhëtimeve të panevojshme;
  - b) Një grup monitorimi (prej të paktën 2 monitoruesish) duhet të realizojë të paktën 115 monitorime në vit (57 monitorime për monitorues). Kjo nisur nga nevoja për monitorime vjetore te lejeve/autorizimeve dhe burimeve ujore - rreth 1500 subjekte/burime (kryerja e të paktën 2-3 monitorime në javë nga një grup);
  - c) Në monitorim, monitoruesit duhet të jenë të pajisur me logjistikën e nevojshme për të kryer funksionet e monitorim/kontrollit përfshirë këtu edhe matjen e parametrave të cilësisë së ujërave.
- II. Planet/programet vjetore të monitorim/kontrollit hartohen nga ZABU dhe dërgohen për miratim pranë Drejtorit të Përgjithshëm të AMBU-së, brenda datës 10 të muajit dhjetor të vitit parardhës dhe miratimi i tyre nga Drejtori i Përgjithshëm i AMBU-së, vjen pas vlerësimit nga Sektori i Monitorim/Kontrollit pranë AMBU-së, në lidhje me përmbushjen e kërkesave edhe të metodologjisë në fjalë.
- III. Vlerësimi i realizimit të programeve të monitorimit do të kryhet edhe kundrejt zbatueshmërisë së kërkesave të metodologjisë.
- IV. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

## DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Gerta Lubonja

